



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63, nenit 12 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të nenit 8, germa b) të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 10 Qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

për çregjistrim të partisë politike Samostalna Liberalna Stranka-SLS

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çregjistrim dhe largimin nga regjistri i partive politike të partisë politike "Samostalna Liberalna Stranka-SLS", për mosdorëzimin e Formularit për vazhdimin e regjistrimit në pajtim me nenin 7 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- II. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike "Samostalna Liberalna Stranka-SLS", për marrjen e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Partia politike, "Samostalna Liberalna Stranka-SLS" me akronimin SLS e regjistruar më 14 Prill 2006, nuk ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 7 i Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht nuk e ka dorëzuar Formularin për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike që duhet të dorëzohet deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik si dhe pas afatit shtesë të dhënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve deri më 5 Qershor 2020.



Këshillë juridike: Partia Politike, "Samostalna Liberalna Stranka-SLS" me akronimin SLS, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP, brenda 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për pezullim nga regjistri i partive .